



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dërguar Prilapen / Proshiro Received / Delivered	24.03.2022	2	viti god year
Organ / Niveli Organ / Jedinica Org / Unit	Id / Prok Id / Prok Id / Prok No	Shloja e Enesig Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOM/BRK	1571/2022		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.100/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.100/2022 të datës 08.02.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adrese banim [redacted] kundër "Policisë së Kosovës" në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.03.2022 mori këtë:

### V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.100/2022 e datës 08.02.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

### A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] sipas shkresave të lëndës i punësuar në policinë e Kosovës në pozitën "Asistent Administrativë" në Departamentin pranë Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosovës. Ankuesit përmes emailit zyrtar të datës 03.03.2021 të Drejtorit të Divizionit për Personel dhe Administratë, për shkak të grubmllit të unëve në "Njësin për Punë Ditësore dhe Jashtë Detyrës Zyrtare", si rezultat i mungesës së nëpunëses AK e cila gjendet në pushim, e liruar sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës si dhe në pushim vijues për shkak të pushimit të lehonisë nga data 01.03.2021 deri me datën 18.10.2021.

Ankuesi me datë 10.01.2022 ka parashtruar kërkesë tek Drejtoria e Personelit në Policinë e Kosovës, ku ka kërkuar që ti bëhet kompensimi në pagë për periudhën kohore 01.03.2021 deri me 18.10.2021, ndërsa Policia e Kosovës nuk i është përgjigjur në kërkesë.



Ankuesi me datën 08.02.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 595/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimin ankimore që ti kompensohet në pagë ndryshimi nga paga e asistentit në Zyrtar i Lart për Financa për periudhën kohore 01.03.2021 deri me 18.10.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.02.2022, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Policia e Kosovës më datë 28.02.2022 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 595/2022 të datës 08.02.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emalin e datës 03.03.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 697/2022 të datës 11.02.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1067/2022 të datës 28.02.2022; Vendimin e datës 02.11.2017; Kontratën e punës të datës 11.09.2015.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit [REDACTED] është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që organi i punësimit Policia e Kosovës, është i obliguar që në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, të bëjë ndryshimin lidhur me kompensimin i pagës, për periudhën nga data 01.03.2021 deri me datën 18.10.2021, për arsye se ankuesi i ka kryer për veç detyrave që i mbanë për pozitën "Asistente", gjatë kësej kohe ka kryer edhe detyra të punës për pozitën "Zyrtar i Larte për Financa", për kolegen e punës e cila sipas dispozitave ligjore ka qenë e liruar nga puna për arsye të COVID-19.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar që ankuesi zëvendësimin në pozitën Zyrtar i Lartë për Financa e ka bërë më bazë të emalit të datës 03.03.2021, dhe për këtë nuk ka pasur vendim për kryerjen e kësaj detyre, si rrjedhojë edhe në kontratën e punës së ankuesit është e specifikuar që "Kryen edhe punë tjera që ja përcakton mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të cilat me arsye mund të kërkojnë kohë pas kohe e të cilat nuk cenojnë dinjitetin e punonjësit", në këtë kuptim këtë punë shtesë e ka kryer sipas kërkesës së udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë.

Në bazë të provave të lëndës, nuk ka asnjë akt administrativ, me të cilin ankuesi është ngarkuar me detyrat e Zyrtar i Lartë për Financa, dhe nga i cili akt do të dalin edhe detyrimet nga institucioni për kompensim gjatë ushtrimit të detyrave, atëherë sipas vlerësimit të Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, kompensimi i nëpunësve civil mund të bëhet vetëm nëse ka akt administrativ i cili parasheh një gjë të tillë.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar që nuk ka asnjë dëshmi që ankuesit detyrat e përcaktuar me emalin e datës 03.03.2021 t'i ketë ushtruar jashtë orarit të punës, kështu që ankuesi me emalin e datës 03.03.2021 është





caktuar ti kryej edhe detyrat e Zyrtarit të Lartë për Financa, të cilën detyrë nuk e ka kundërshtuar edhe pse në këtë emali nuk ka pasur asnjë pikë ku do të bëhet kompensimi për këtë zëvendësim. Neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil ka përcaktuar edhe kompensimin e pagës dhe pagesat e tjera, ku theksohet: *Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës në këto raste: 1.1. kompensim për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës; 1.2. kompensim për punë jashtë orarit gjatë fundjavës dhe 1.3. kompensim për punë jashtë orarit gjatë festave zyrtare; 1.4. kompensim për pushim vjetor; 1.5. kompensim për kohën e paaftësisë së vërtetuar të përkohshme për shkak të sëmundjes; 1.6. kompensim gjatë shtatzënisë dhe lehonisë; 1.7. kompensim në rast të shfrytëzimit të pushimit të veçantë me pagesë; 1.8. kompensim në rast të perfeksionimit profesional të specializuar për nevojat e organit ose të shtetit*, andaj nëse i referohemi këtyre dispozitave ankuesi nuk ka plotësuar asnjërin nga kushtet e lartcekura për t'u kompensuar, rrjedhimisht pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**LËNDA ME NUMËR A.NR.100/2022**

Ilire Mehmeti Shaqiri

*Ilire Mehmeti Shaqiri*  
Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

*Eshref Shabani*  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

